

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE), SHA, TIRANË

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të auditimit nr. 495/1 prot, datë 21.05.2015, i ndryshuar, ushtroi auditim në shoqërinë “Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE) Sh.a., Tiranë, në përfundim të të cilit është konstatuar një dëm tërësor ekonomik në vlerën 32,039,440 euro, si dhe të ardhura të munguara për shoqërinë OSHEE dhe për Buxhetin e Shtetit në vlerën 5,630,713 euro, duke depozituar njëkohësisht pranë organit të Prokurorisë edhe kallëzimin penal nr. 495/21, datë 25.09.2015 për ish-Administratorin e CEZ Shpërndarje Sh.a., si dhe dy ish drejtues të lartë të saj shoqërie, për periudhën kur kjo shoqëri ka qenë nën administrim të përkohshëm të Shtetit Shqiptar.

Më konkretisht, për periudhën e audituar 21.01.2013 deri me datë 30.06.2015, nga auditimi është evidentuar keqmenaxhimi i kësaj shoqërie për sa i përket: blerjes së energjisë elektrike, zbatimit të procedurave të blerjes së materialeve dhe pajisjeve elektrike, zbatimit të procedurave të prokurimit publik, sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhënies së pagave dhe shpërblimeve, hartimin dhe mbajtjen e pasqyrave financiare, , etj.

1) Nga auditimi i blerjes së energjisë elektrike, për periudhën Janar – Korrik 2014, nga CEZ Shpërndarje SHA, rezultoi se është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 2,96 miliard lekë, ose 21,238,860 euro, si rrjedhojë e:

a) Blerjes së energjisë elektrike me çmime më të larta se ato të tregut

Nga moszbatimi i rregullt i procedurave të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistem, për periudhën Janar-Korrik 2014, nga shoqëria “CEZ Shpërndarje” Sha, është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 1,357,823 mijë lekë ose 9,727,223.4 euro. Konkretisht blerja e energjisë elektrike është kryer me çmime shumë më të larta se çmimet e tregut (përfshirë dhe kostot të transportit të energjisë), nga 7.94 euro deri në 13.12 euro për Mwh.

b) Mbifaturimit të konsumatorëve, i realizuar me anë të uljes artificiale të humbjeve teknike. Nëpërmjet uljes artificiale të humbjeve teknike, është shkaktuar një dëm i interesave të ligjshme të shoqërisë “KESH” sha dhe buxhetit të shtetit, për 2014, në vlerën 1,547,032 mijë lekë, ose 11,082,687 euro.

Konkretisht për vitin 2014 u konstatua se në mënyrë artificiale janë ulur humbjet teknike, veprim i cili është kryer me fatura të dyshimta (mbi faturim, keq faturim, faturim të abonentëve pa adresë si dhe abonentë që nuk kanë arkëtuar asnjëherë etj), si pasojë e të cilës i është krijuar një dëm ekonomik shoqërisë “Kesh” sh.a dhe buxhetit të shtetit në vlerën 1,547,032 mijë lekë, ose 11,082,687 euro. Ky faturim është bërë në mënyrë abuzive dhe të pasaktë, pasi reflekton një sasi të pa konsumuar të energjisë elektrike, por edhe një faturim fiktiv me abonent që nuk kanë arkëtuar asnjëherë (të cilët rezultojnë aktiv në sistemin e faturimit, ndoshta nuk ekzistojnë etj).

c) Blerjes së energjisë elektrike nga kompani të lidhura ndërmjet tyre.

Nëpërmjet blerjes së energjisë elektrike nga tre kompani të lidhura ndërmjet tyre (një kompani mëmë dhe dy bija), për mbulimin e humbjeve të energjisë në sistemin e shpërndarjes për periudhën Korrik 2014 – Mars 2015, është shmangur konkurrenca, duke sjellë si pasojë një dëm ekonomik për llogari shoqërisë CEZ Shpërndarje sha dhe më pas për OSHEE sha, në vlerën 59,877 mijë lekë ose 428,950 euro.

2) Nga auditimi i blerjes së materialeve dhe pajisjeve elektrike nga shoqëria ÇEZ Shpërndarje, përgjatë vitit 2014, rezultoi që është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 4,359,882 euro, si rrjedhojë e shkeljeve të procedurave të tenderimit të vendosura nga ERE në “Rregullore e Prokurimeve të CEZ Shpërndarje sha”, lidhur me trajtimin e procedurave si raste emergjente, realizimit të tyre me një fazë negociimi, kryerjes së shtesave të kontratave në

vlera të konsiderueshme që arrinin deri në 50% apo 70 % të vlerës së kontratës bazë, si dhe blerjes në disa raste të materialeve dhe pajisjeve elektrike pa zhvilluar procedura tenderimi.

3) Nga auditimi i pjesshëm për shkak të dokumentacionit të mangët ekonomiko-financiar, i disa prej kompanive të mbledhjes së borxhit të energjisë elektrike rezultoi që këto kompani kanë përfituar padrejtësisht nga CEZ Shpërndarje Sha, së paku vlerën prej 6,074,478 euro, për të cilën grupi i auditimit të KLSH shprehet me rezervë si pasojë e:

- Mungesës së një inventari të plotë të llogarive (inventar fizik të aseteve dhe inventar kontabël) të Shoqërisë “CEZ Shpërndarje” Sha, si në momentin e kalimit të kësaj shoqërie nën administrimin e përkohshëm të shtetit më datë 21.01.2013, ashtu edhe pas kësaj date deri në periudhën e përfundimit të këtij auditimi.

- Mosdisponimit të programeve autentike të Shoqërisë “CEZ Shpërndarje” Sha (SAP - Programi i kontabilitetit, Billing – Programi i faturimit dhe Mobirid- Programi i leximit të matësve), mbi bazën e të cilave kjo kompani menaxhonte dhe administronte aktivitetin e saj, që nga momenti i kalimit të kësaj shoqërie nën administrimin e përkohshëm të shtetit dhe deri më periudhën e përfundimit të këtij auditimi.

- Ekzistencës së të dhënave kontradiktore në dokumentacionin e disponuar në OSHEE nga dega ekonomike, drejtoria ligjore dhe drejtoria e shitjes.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua që për katër kompanitë e audituara, nga ana e Shoqërisë “CEZ Shpërndarje” Sha, nuk disponohej dokumentacioni i plotë për justifikimin e pagesave të dhëna këtyre kompanive të mbledhjes së borxheve, duke ngritur kështu dyshime serioze për shumat e përfituara padrejtësisht prej këtyre kompanive nga Shoqëria “CEZ Shpërndarje” Sh.a.

Në mungesë të ekzistencës së dokumentacionit të plotë justifikues për zbatimin e detyrimeve kontraktore të kompanive të mbledhjes së borxheve, vlera prej 6,074,478 euro do të konsiderohet si dëm ekonomik i përfituar në mënyrë të padrejtë nga ana e tyre.

Në lidhje me këtë konstatim, KLSH i ka rekomanduar Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të OSHEE, marrjen e masave të menjëhershme për të përfshirë në veprimtarinë e saj audituese, aktivitetin e të gjitha kompanive të mbledhjes së borxhit të keq të energjisë elektrike duke analizuar në veçanti kallëzimin penal të Avokaturës së Shtetit, përcjellë organit të Prokurorisë me shkresën nr. 526/34, datë 24.07.2013, si dhe të organizojë punën për auditimin e plotë të veprimtarisë administruese dhe menaxhuese, ekonomike dhe financiare të CEZ Shpërndarje Sha, për periudhën e administrimit të përkohshëm të kësaj kompanie, duke filluar nga data 21.01.2013.

4) Nga auditimi i zbatimit të kuadrit rregullator në dhënien e pagave dhe shpërblimeve rezultoi që është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 336,986 euro, si rrjedhojë e pagesave të tepërta për shpërblime në fund të vitit, si dhe një dëm ekonomik në vlerën 29,232 euro porsa i përket shpenzimeve të ndryshme operative.

5) Nga auditimi i blerjes së energjisë elektrike në muajin dhjetor 2014 u konstatuan të ardhura të munguara për shoqërinë OSHEE dhe për buxhetin e shtetit, të krijuar nga eksporti i energjisë nga KESH sha dhe importit të energjisë nga OSHEE në vlerën 5,630,713 euro, ku OSHEE kishte blerë energji elektrike me çmim 22,32 Euro/Mwh më të lartë se sa çmimi i shitjes së KESH sha në këtë periudhë.

Gjithashtu, nga auditimi rezultoi që ERE, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka krijuar një situatë konfuzë në sistemin energjetik, jo vetëm në aktet e nxjerra prej saj, por dhe në monitorimin e shoqërive që operojnë në sistemin energjetik, me pasoje financiare për buxhetin e shtetit, kryesisht duke mos përcaktuar detyrimin e dy shoqërive KESH dhe CEZ për të rakorduar në lidhje me tepricat e prodhimit të KESH sha. Situatë e cila është përmirësuar vetëm në Shkurt 2015, nëpërmjet vendimit të ERE nr. 12, datë 06.02.2015 dhe marrëveshjes përkatëse ndërmjet KESH dhe OSHEE.

Veç sa më sipër, auditimi i KLSH ka evidentuar që nga ana e CEZ Shpërndarje Sh.a., nuk janë ndjekur procedurat për hartimin, miratimin e projekt-programit ekonomik dhe financiar, nuk është raportuar periodikisht në ERE; nuk është miratuar niveli i pagave të punonjësve në ministrinë përkatëse; ka diferenca në inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme; ekzistojnë mospërputhje e llogarive të arkëtueshme midis sistemit të faturimit dhe të dhënave të kontabilitetit për faturat e papaguara nga abonentët, si dhe mospërputhje e detyrimeve për huat afatgjata me KESH SHA; ka mangësi në zbatimin e procedurave të prokurimit publik dhe në zbatimin e kontratave, nuk është ngritur njësia e prokurimit; studimi i vlerës së kontratës nuk është plotësisht i saktë; nuk është hartuar dhe miratuar një plan strategjik auditimi dhe plan vjetor i punës së departamentit të auditit të brendshëm; ka mangësi në procedurat dhe zbatimin e tyre për blerjen e energjisë elektrike dhe mbledhjen e borxhit të shoqëruara me dëm ekonomik, etj.

Në total, nga auditimi rezultoi që dëmi ekonomik që i është shkaktuar buxhetit të CEZ Shpërndarje Sh.a. (aktualisht OSHEE) dhe për rrjedhojë edhe buxhetit të shtetit, arrin në vlerën 32,039,440 Euro dhe të ardhurat e munguara arrijnë në vlerën 5,630,713 Euro.

Me shkresën nr. 495/21, datë 25.09.2015, KLSH ka depozituar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, kallëzimin penal për A.S. në cilësinë e ish-Administratorit të shoqërisë CEZ Shpërndarje Sh.a., (përgjatë vitit 2014); E.Z. në cilësinë e ish-Drejtorit të Departamentit të Shitjes në CEZ Shpërndarje Sh.a.; dhe J.Z. në cilësinë e ish-Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse në CEZ Shpërndarje Sh.a., të cilët në mospërmbushje të rregullt të detyrës së tyre funksionale kanë konsumuar elementët e figurës së veprave penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe më konkretisht për shkeljet e konstatuara në lidhje me:

- Blerjen e pajisjeve dhe materialeve elektrike emergjente për nevojat e shoqërisë, në vitin 2014,
- Mospëzbatimin e kuadrit rregullator për blerjet e energjisë elektrike, duke e blerë atë me çmime më të larta se ato të tregut, si dhe
- Uljen artificiale të humbjeve teknike, të realizuar nëpërmjet mbifaturimit të konsumatorëve.

Gjithashtu, referuar Vendimit nr. 119, datë 24.09.2015 të Kryetarit të KLSH-së në lidhje me këtë auditim, në të janë përcaktuar dhënia e rekomandimeve për 30 masa organizative, 16 masa të ndryshme disiplinore që variojnë nga zgjidhja e kontratës së punësimit deri në vërejtje, si dhe 9 masa zhdëmtimi.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 495/20, datë 24.09.2015, dërguar z. Ardit Çela, Administrator i OSHEE, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës, vendimet e marra prej tij dhe zbatimi, u konstatua që:

-Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës nuk ka lidhur kontratë “Për administrimin e shoqërisë” me administratorin e shoqërisë, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, i ndryshuar, pjesa II, pika 6 gërma c.

- Nga Këshilli Mbikëqyrës, nuk është miratuar program i auditit të brendshëm dhe nuk është kontrolluar veprimtaria e tij për periudhën 3/mujore, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin,

funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore” pjesa IV, pika 6 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 25-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Kryetari Këshillit Mbikëqyrës të merren masat për të lidhur kontratë “Për administrimin e shoqërisë” me Administratorin e Shoqërisë “OSHEE”, Sh.a Tiranë, në zbatim të Udhëzimit nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore” pjesa II, pika 6.

Menjëherë

-Këshilli Mbikëqyrës, të miratoj çdo vit programin vjetor të auditimit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, si dhe të ushtroj kontroll për zbatimin e tij çdo tremujor, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, Kreu IV, pika 6.

Menjëherë dhe vazhdimisht

2. Nga auditimi mbi hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e programit ekonomik-financiare në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet e prore, si dhe realizimi i tij, u konstatua që:

-Nuk janë ndjekur procedurat për hartimin, miratimin e projekt-programit ekonomik dhe treguesit ekonomik për vitet 2014, si dhe raportimi periodike në ERE, veprime këto që bien ndesh me Vendimin e ERE nr. 1, datë 10.01.2013 “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, neni 17, pika a.

-Procedurat e ndjekura për hartimin, miratimin e projekt-programit ekonomik dhe treguesit ekonomik për vitin 2015, është në shkelje të afateve dhe procedurave për hartimin, miratimin dhe dërgimin në MZHETTS, veprime këto që bien ndesh me pikën III/3,4,5, të Udhëzimit nr. 394, datë 21.08.2014, “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”.

-Konkretisht, programi ekonomik për vitin 2015 është hartuar nga shoqëria dhe pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës, me vendimin nr. 3 datë 06.02.2015, është miratuar nga MZHETTS me shkresën nr. 1065/3 prot., datë 27.04.2014, pra 4 muaj nga fillimi i aktivitetit, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, kreu III, pika 2, ku në të cili nga ana e drejtorisë së shoqërisë praktika e plotë e projekt-programit përcillet brenda datës 01 nëntorit të çdo viti për miratim në Këshillin Mbikëqyrës dhe deri më 30 janar të çdo viti, për miratim përfundimtar në MZHETTS, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Shtetërore, Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike (*Trajtuar më hollësisht në faqet 30-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Përgjithshëm, të miratojnë programin ekonomik-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, dhe nëse është parashikuar në statut dhe ligjet specifike, të miratohet edhe nga Aksioneri i vetëm, “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, si dhe të marrin masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

Vazhdimisht

3. Nga auditimi mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, u konstatua që:

-Për vitin 2013, shoqëria “CEZ Shpërndarje” Sha në administrim të përkohshëm, ka dhënë shpërblime në fund të vitit për të gjithë punonjësit në masën e 10,000 lekë, në shumën 47,040,000.00 lekë, kjo shumë përbën dëm ekonomik për shoqërinë, sepse është dhënë në

kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodin e Punës”, i ndryshuar, neni 114-Shpërblimi, pika 1, e cili përcakton se: “Nëse palët bien dakord, punëdhënësi i jep punëmarrësit një shpërblim të veçantë mbi pagë, në fund të vitit, duke marrë parasysh cilësinë e punës së tij ose mbarëvajtjen e ndërmarrjes”, si dhe Vendimin e ERE nr. 1, datë 10.01.2013 “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, neni 12, pika 3, ku përcaktohen kompetencat e Administratorit, dhe detyrimin për miratim në ERE të strukturës, pagave dhe shpërblimeve.

- Shoqëria për vitet 2014 e 2015, nuk ka miratuar nivelin e pagave nga Ministria e linjës si dhe funksionon mbi një vendim të ERE nr. 191/1 prot., datë 19.02.2013 në vijim të vendimit nr. 21 dhe 22 datë 18.02.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Mbi kërkesën për miratim të klasifikimit të personelit dhe strukturës së pagave të punonjësve të “CEZ Shpërndarje” Sha (në administrim të përkohshëm)”, ku niveli i klasave në këtë vendim është bërë në 4 grupe, por në këtë klasifikim, nuk janë përcaktuar kriteret që i diferencojnë këto klasa.

-Për periudhën objekt auditimi, organigrama e shoqërisë ka pasur një ndryshueshmëri të shpeshtë. Struktura organizative nuk është e plotë dhe gjithë përfshirëse, duke mos marrë në analizë të gjitha Drejtoritë Rajonale dhe Drejtoritë e Tensionit të Lartë, si dhe duke mos pasqyruar një numër real dhe të miratuar të për të gjithë organigramën të shoqërisë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa që shpërblimet për punonjësit në fund të vitit, të jepen sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, dhe vetëm pas daljes dhe miratimit të rezultatit ekonomik-financiar të shoqërisë me fitim dhe të miratuar nga Aksioneri i vetëm, “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”.

Vazhdimisht

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa për miratimin e nivelit të pagave në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në zbatim të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, shkronja a.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Nga Administratori i Shoqërisë, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbare, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Administratori i Shoqërisë dhe Departamenti Ekonomik, të analizojnë me saktësi numrin e fuqisë punëtore aktuale dhe ta harmonizojë atë me nevojën aktuale dhe perspektivën e organizimit dhe funksionimit të Shoqërisë, duke marrë në kohë masat e nevojshme organizative, procedurale dhe ligjore në këtë drejtim.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të hartohet rregullorja e përcaktimit të kriterëve të punësimit sipas pozicionit të vendeve të punës, dhe të merren masa për zbatimin korrekt në rekrutimin apo lëvizjen e punonjësve.

Brenda datës 31.12.2015

4. Nga auditimi mbi mbajtjen e evidencës kontabile në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit, u konstatua që:

-Ka diferenca në inventarizimin e AQT-ve, inventarizim që vazhdon nga grupet e punës, në zbatim të urdhrave të Administratori të Shoqërisë nr. 15.1, datë 20.12.2014 dhe nr. 15.2, datë 13.01.2015.

-Instalimi i matësve në vitin 2013 me vlerë 360 milion lekë vazhdon të pasqyrohet në bilanc si “Investime në proces”. Nga shoqëria janë marrë masat për sistemimin e tyre, por gjendja deri në fund të vitit 2014, nuk ka ndryshuar.

-Ekzistojnë mospërputhje e llogarive të arkëtueshme midis sistemit të faturimit (billingu) dhe të dhënave të kontabilitetit për faturat e papaguara nga abonentë për energji që “CEZ Shpërndarje” Sha i ka shitur. Vlera e këtij mos rakordimi në fund të vitit 2013 është rreth 1.1 miliard lekë. Këto diferenca i përkasin periudhës 2010-2011. Kjo diferencë është rritur në rreth 1.3 miliard lekë në fund të vitit 2014, dhe po punohet me grup pune për sistemimin e tyre duke rakorduar detyrimet me Postën Shqiptare SHA.

-Konstatohet mospërputhje e detyrimeve për huat afatgjata me KESH SHA, detyrim i cili deri më 31.12.2013 është 527 milion lekë.

-Në fund të vitit 2013 ka mos rakordim të llogarive të pagueshme tregtare të pashlyera të KESH SHA të periudhës 2010-2012 në vlerën 2,2 miliard lekë. Gjendja mbetet e pandryshuar dhe në fund të vitit 2014. Aktualisht dy kompanitë po punojnë për rakordimin e këtyre llogarive në zbatim të VKM nr. 144, datë 12.03.2014 “Për zgjidhjen e çështjeve të borxhit në disa institucione publike në sektorin e energjisë”

-Konstatohet mos rakordim i llogarive të pagueshme tregtare të pashlyera të OST SHA të periudhës 2009-2012 në vlerën 1.7 miliard lek, që përbëjnë interesa për pagesa të vonuara, për të cilat po punohet, për rakordimin e tyre.

-Konstatohet mos rakordim i llogarive të pagueshme tregtare ndaj Postës Shqiptare SHA. Këto mospërputhje i referohen faktit që Posta Shqiptare SHA i ka mbajtur shoqërisë një pjesë të arkëtimit nga faturat e energjisë si kompensim i detyrimeve që ka shoqëria. Për vitin 2014 është bërë rakordimi dhe po punohet për pjesën që Posta ka pa likuiduar. Gjatë rakordimit ka pasur mospërputhje të sistemit të faturimit (billingu) dhe kontabilitetit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 51-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Administratori i Shoqërisë dhe Departamenti Ekonomik të merren masa për përfundimin e inventarizimit të aseteve.

Nga Administratori i Shoqërisë dhe Departamenti Ekonomik të merren masa për përfundimin e rakordimeve të detyrime me KESH SHA dhe OST SHA, deri në fund të vitit 2015.

Nga Administratori i Shoqërisë, Departamenti Ekonomik dhe Departamenti i Shitjes, të merren masat e nevojshme për përmirësimin e sistemit të faturimit me kontabilitetin, për të eliminuar mospërputhjet në veçanti me Postën Shqiptare SHA.

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të analizojnë gjendjen debitore dhe kreditore më datë dhe 31.12.2014, si dhe të marrë masat e nevojshme për reduktimin e tyre.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të kryejë një auditim tematik në lidhje me diferencat e inventarizimeve, instalimin e matësve dhe mungesën e rakordimit të llogarive, t’ja paraqesë Këshillit Mbikëqyrës duke përcaktuar masat përkatëse për shmangien e këtyre mangësive dhe evidentimin e përgjegjësive.

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të analizojnë shkaqet dhe faktorët që ndikojnë në humbjet e kësaj shoqërie, si dhe të marrin masa të nevojshme për të mundësuar drejtimin e shoqërisë, drejt rezultateve pozitive.

Brenda datës 31.12.2015

5. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua që:

-Në një rast objekti është ndërtuar pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjin nr. 8402, datë

10.09.1998 “Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit.

-Në fillim të vitit 2015, nuk është ngritur njësia e prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” neni 57, e cila duhet të administrojë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit. Njësia e prokurimit të përbëhet të paktën nga 3 persona me arsim të lartë, ku njëri prej tyre duhet të jetë jurist.

-Në pesë procedura prokurimi studimi i vlerës së kontratës nuk është plotësisht i saktë, pasi në përcaktimin e fondit limit, nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si dhe çmimet e botuara nga INSTAT-i, çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, janë mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga AK, janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, neni 59 "Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës".

-Në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim. Ky veprim bie në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”.

-Specifikimet teknike nuk janë hartuar plotësisht në përputhje me nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi ato nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatimi ose tipi, origjinë specifike, prodhuesi ose sipërmarrje shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “*ose ekuivalent*” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për shkaqet subjektive që vërehen në procedurat e anuluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit. Autoriteti kontraktor publikon njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç është publikuar njoftimi i kontratës, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit për anulim.

-Në pesë procedura tenderimi, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer ***në mënyrë të padrejtë***, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”. Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

-Në një rast komisioni i vlerësimit të ofertave është formuar pa specialist të fushës, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” në kundërshtim me Neni 58 "Komisioni i vlerësimit të ofertave "Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës".

-Në tre procedura tenderimi, nuk është bërë çlirimi i sigurimit të ofertës pas lidhje së kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, neni 18 "Sigurimi i ofertës".

-Në tre procedura tenderimi, nuk është paraqitur nga ana e operatorëve fitues, polica e sigurimit, në kundërshtim me nenin 25.2 të kushteve të përgjithshme të kontratës, ku në

mënyrë eksplicite citon “Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit me aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion do të mbulojë kompensimin e kërkuar për të mbuluar humbjen e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, AK, mund të vendos të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit, ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrësë koston e tij, nga pagesa që i jep kontraktorit”.

-Në pesë procedura tenderimi, njësia e prokurimit ka miratuar dokumentet e tenderit, kërkesat për kualifikim, specifikimet teknike, ndërsa kriteret e vlerësimit nuk i ka përcaktuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa që investimet për ndërtimet dhe rikonstrukcionet të kryhen me leje zhvillimi, në zbatim të Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit.

Vazhdimisht

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa që në fillim të vitit, të ngre njësinë e prokurimit, e cila duhet të administrojë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit. Njësia e prokurimit të përbëhet të paktën nga 3 persona me arsim të lartë, ku njëri prej tyre duhet të jetë jurist, në zbatim të VKM nr. 914 date 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” neni 57. Për një përdorim me efikasitet të fondeve publike të argumentohet domosdoshmëria e kryerjes së prokurimit me leverdinë ekonomike dhe volumet efektive të punëve që do të kryhen;

- Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike. Këto kërkesa duhet të kenë në konsideratë edhe faktin që të kushtëzojnë kualifikimin e operatorëve në vartësi të shlyerjes/ose jo të detyrimeve financiare ndaj OSHEE, zgjidhjes së njëanshme të kontratave, ose mos përmbushjes të të gjitha detyrimeve kontraktore. Ky rekomandim mbështetet në frymën e ligjit për prokurimin publik si dhe në rregullat e prokurimit publik.
- Nga Administratori i shoqërisë t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste konstatohet jo korrekt.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organet kompetente.
- Për të përcaktuar përgjegjësinë individuale, të bëhet ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të Njesisë së Prokurimit dhe të miratohet nga titullari i Autoritetit Kontraktor,
- Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 date 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

6. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, u konstatua që:

-Nga Këshilli Mbikëqyrës nuk është hartuar dhe miratuar një plani strategjik auditimi dhe plan vjetor i punës së departamentit të auditit, në kuadër të veprimtarisë së auditit të Brendshëm bazuar në ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, ndryshuar .

-Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE), SHA Tiranë, nuk disponon udhëzim rregullativ të shkruar lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në lidhje me përcaktimin e strukturave menaxheriale, përcaktimin e nëpunësit autorizues, nëpunësit zbatues dhe përgjegjësitë përkatëse, si dhe linjat e raportimit. Këto rregullime duhet të ishin pasqyruar edhe në rregulloren e brendshme të Shoqërisë, pasi ajo funksionon aktualisht, me rregulloren e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, me vendim nr. 24, datë 03.04.2015.

-Menaxhimi i zërave të shpenzimeve, sanksionohet me Rregullore të Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, por kjo rregullore, duhet të ishte përmirësuar në funksion të ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, dhe ndryshimeve ligjore dhe nënligjore në funksion të këtij ligji.

-Ka patur mangësi në auditimin dhe vlerësimin në disa fusha si menaxhimi i riskut, vlerësimi i veprimtarisë së TI dhe vlerësimi i performancës në shkallë kompanie, pasi nuk janë kryer auditime të plota për këto departamente.

-Menaxhimi i vlerave materiale, inventarizimi dhe nxjerrjet jashtë përdorimi rregullohen, mbështetur në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrit të Financave “Për menaxhimin e aktiveve të Njësive të sektorit publik”.

-Nuk është parashikuar në akte të veçanta, rregullimi i menaxhimit operacional, për urdhrat e kundërshtuar dhe rregullat për delegimin e detyrave, si dy operacione kryesore në menaxhimin financiar.

Të gjithë këto mangësi në procedura dhe rregulla të shkruara, ndikojnë në mos menaxhimin si duhet të vlerave materiale, si dhe në mos funksionimin, si duhet të hallkave të kontrollit të brendshëm. Rregullimi me akte të miratuara për menaxhimin e sistemeve të veçanta, ndihmon në menaxhimin efektiv, shmang abuzimet, rrit efektivitetin e përdorimit të fondeve, si dhe adreson përgjegjësitë personale për çdo specialist, sipas niveleve të autorizimit.

Drejtoria Ekonomike, duhet të pozicionohet më qartë si njësi e ngarkuar me ligj, për menaxhimin financiar, si njësi kryesore zbatuese dhe kjo kërkon hartimin e një rregulloreje, ku të përcaktohen funksionet të ndara qartë ndërmjet nëpunësit autorizues, i cili në çdo rast është Administratori i Shoqërisë, nëpunësit zbatues, nëpunësit kontrollues që ekzekutojnë pagesat dhe regjistruarit në kontabilitet (*Trajtuar më hollësisht në faqet 127-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa për hartimin e planit strategjik dhe vjetor të Drejtorisë të Auditit të Brendshëm, në kuadër të veprimtarisë dhe funksionimit të këtij Drejtorie, në zbatim të Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

Brenda datës 31.12.2015

Këshilli Mbikëqyrës të ngarkojë Drejtorinë e Auditit të Brendshëm dhe Administratorin e Shoqërisë, të marrë masa për hartimin e Udhëzuesit rregullativ, të shkruar lidhur me zbatimin e ligjit për Menaxhimin Financiar, duke përcaktuar strukturat menaxheriale, nëpunësin autorizues, nëpunësin zbatues dhe përgjegjësitë përkatëse.

Brenda datës 31.12.2015

Nga Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i Shoqërisë, të rishikohet Rregullorja Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Shoqërisë, dhe të bëhen rregullimet e nevojshme në lidhje me përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësitë të pozicioneve sipas drejtorive deri në nivel specialisti.

Brenda datës 31.12.2015

7. Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale, u konstatua që:

Pronësia e aktiveve afatgjata materiale, vazhdon të jetë një problemet shqetësues për shoqërinë “OSHEE”. Deri në fund të vitit 2014 nga 7366 pasuri të paluajtshme kaluar shoqërisë me VKM nr. 1108, datë 30.07.2008, vetëm 3170 prej tyre janë regjistruara në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 137-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të zbatohen procedurat ligjore nga Shoqëria “OSHEE” Sha, për të regjistruar në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet.

Brenda datës 30.06.2016

8. Nga auditimi mbi zbatimin rregullave dhe procedurave të shitje-blerjes të energjisë elektrike, u konstatua që:

8/1. Mbi refuzimin nga me detyrë ish-administrator i përkohshëm për periudhën 18.10.2013 deri më 03.11.2014, të kryerjes së auditimit të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” Sha, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

KLSH në programin e auditimit për vitin 2014 përfshiu auditimin e “CEZ Shpërndarje” Sha në lidhje me këto procedura shit-blerjes të energjisë elektrike, duke njoftuar ÇEZ-in me shkresën nr. 263 prot., datë 05.03.2014, për fillimin e këtij auditimi.

Auditimi nga ana e KLSH të “CEZ Shpërndarje” Sha, bazohej në Vendimin nr. 4, datë 21.01.2013 të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), sipas të cilit Këshilli i Ministrave do të duhej të vepronte për shpronësimin e asetëve të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” Sha në përputhje me procedurat e parashikuara në Ligjin nr. 8561, datë 22.12.1991 “*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*”, si dhe Vendimin nr. 5, datë 21.01.2013, në bazë të së cilit ERE vendosi kalimin në administrim të përkohshëm të shoqërisë ÇEZ Shpërndarje Sha.

Z. me detyrë Administrator për periudhën 18.10.2013 deri më 03.11.2014, të ÇEZ Shpërndarje Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm ka refuzuar Kontrollin e Lartë të Shtetit për kryerjen e këtij auditimi. Me shkresën nr. 2868/1 prot., datë 10.03.2014, duke u bërë pengesë me pretendimin se shoqëria “CEZ Shpërndarje” Sha, nuk përfshihet në subjektet që i nënshtrohen auditimit nga KLSH.

Veprimi i z. në pengimin e KLSH-së për ushtrimin e detyrave kushtetuese dhe ligjore për zhvillimin e miradministrimit financiar dhe kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomike e financiare, ka qenë i qëllimshëm për të mos evidentuar keq menaxhimin dhe keq administrimin e kësaj shoqërie. “CEZ Shpërndarje” Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm duhej të ishte dhe është subjekt i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke vepruar në mënyrë për shkak se:

- ERE me vendimin nr. 5, datë 21.01.2013, ka kaluar në administrim të përkohshëm shoqërinë CEZ Shpërndarje Sha, duke ja kaluar të gjitha funksionet dhe kompetencat e administrimit administratorit, i cili *do të zbatojë Rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, për të vepruar sipas akteve ligjore dhe rregullatorë në fuqi dhe mbajtur përgjegjësi në përputhje me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*.

- CEZ Shpërndarje Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm, në ato kushte ka pasur karakteristikat e një shoqërie shtetërore, në kuptim dhe zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 213, pika 1, pasi e *zhvillon veprimtarinë tregtare, me interes të përgjithshëm ekonomik dhe aksionet zotërohen në*

mënyrë të tërthortë nga pushteti qendror, i cili ka vepruar si mëmë. Në këtë mënyrë aktiviteti i ERE-s, reflekton veprimet e një shoqërie mëmë ndaj një shoqërie të kontrolluar si CEZ Shpërndarje Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm.

- Sipas nenit 2 të ligjit nr. 114/2014 “Për miratimin e marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ, a.s.”, *kanë kaluar në pronësi të shtetit shqiptar të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), aksionet e krijuara nga CEZ a.s. deri në datën 21.3.2013, datë në të cilën shoqëria është vendosur në administrim të përkohshëm, çka do të thotë se të gjithë asetet dhe veprimtaria e më pastajme e “CEZ Shpërndarje” Sha, si dhe detyrimet e ndryshme janë administruar efektivisht, faktikisht dhe garantuar nga shteti shqiptar.*

- Sipas pikës 5.5 të Marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ, a. s., miratuar me ligjin nr. 114/2014 “Për miratimin e marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ, A. S., CEZ i deklaroi dhe garantoi MZHETTS që përpara datës 21 janar 2013, nuk kish hyrë në ndonjë marrëveshje me ndonjë palë të tretë, qëllimi i së cilës do të ishte krijimi i ndonjë barre, pengu, hipoteke, detyrimi apo interesi sigures mbi aksionet, çka tregon se pas kësaj date veprimtari e kësaj shoqërie është administruar nga shteti shqiptar.

- Nga ana e tjetër, veprimtaria e CEZ Shpërndarje Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm, përbënte një veprimtari me interes të përgjithshëm ekonomik, e sanksionuar dhe në ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike”, pasi midis të tjerave, veprimtaria e shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike të klientëve të mandatuar tariforë, realizohet si shërbim publik.

- Gjatë vitit 2014, “CEZ Shpërndarje” Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm, prej blerjes së energjisë nga KESH Sha me çmim më të lirë se sa çmimi i blerjes nga kjo e fundit prej HEC-eve me fuqi deri në 10 MW dhe deri në 15 MW, i ka sjellë një detyrim buxhetit të shtetit prej 4,898,857.8 mijë lekë, i cili garantohet nga shteti shqiptar.

- Auditimi i “CEZ Shpërndarje” Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm nga KLSH është brenda kompetencave të veta, bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 10, germa “e” në të cilin përcaktohet auditimi i përdorimit, administrimit të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore, si dhe mbrojtja e interesave ekonomike dhe financiare të Shtetit në personat juridikë, në të cilët detyrimet e tyre garantohen nga shteti apo dhe të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, i ndryshuar, neni 7.

Për refuzimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në kryerjen e auditimit të “CEZ Shpërndarje” Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm sipas shkresës së KLSH nr. 263 prot., datë 05.03.2014, në kundërshtim me sa u përkthyer më sipër, ngarkohet me përgjegjësi me detyrë Administrator i shoqërisë gjatë kësaj periudhe.

Kryerja e auditimit nga KLSH në periudhën e kërkuar do të bënte të mundur shmangien e një pjese të konsiderueshme të problematikës së evidentuar më sipër, për periudhën mbas kryerjes së auditimit.

8/2. Procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistem për periudhën janar-korrik 2014 nga “CEZ Shpërndarje” Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm janë shoqëruar me një sërë shkeljesh dhe mangësish, pasi:

- Në periudhën janar-shkurt 2014 nuk është vepruar në blerjen e energjisë elektrike sipas vendimit të ERE nr. 42, datë 25.05.2009 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH Sha”, të përcaktuara në aneksin nr. 1, të Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për Garantimin e Projektit të Privatizimit të OSSH Sha, si dhe procedurat e muajit janar 2014 kanë nisur para daljes së vendimit të ERE (30.12.2013)

për blerjen e energjisë elektrike mbi baza mujore, që me datë 27.12.2013. Në këtë mënyrë i është lënë hapësirë subjektivitetit të administratorit të CEZ-it, z. në përzgjedhjen e kompanive ofertuese, pavarësisht komunikimit të vazhdueshëm me ERE-n, duke zbatuar një mënyrë mikse blerje pa një rregullore dhe vendim të ERE-s;

- Në periudhën mars-korrik 2014, ndryshe nga përcaktimi në draft-kontratën e furnizimit me energji elektrike prej 2% shtesë, penaliteti për pagesë të vonuar është vendosur në 7 % shtesë për kompaninë GSA, si dhe 8 % shtesë për kompaninë EFT AG;

- Kompanitë shitëse të energjisë elektrike, në disa raste kanë sjellë oferta me dy dhe tre opsione dhe jo për dy tre lote, me çmime të diferencuara për fazën e parë të negocimit dhe që bashkohen në ofertën finale, në kundërshtim me paragrafin e parafundit të ftesës për blerje;

- Draft- kontrata nuk është në përputhje të plotë me “Rregulloren e procedurave të blerjes nga KESH Sha (KESH GEN/FPSH) të energjisë elektrike, nga tregtarët vendas dhe të huaj”, pasi ka tejkallim të kompetencave të CEZ-Shpërndarje, Shoqëri në administrim të përkohshëm lidhur me anulimin e procedurës së blerjes, vetëm për shkaqe të përligjura;

- Është ulur niveli i transparencës së procedurave të blerjes së energjisë elektrike, pasi adresat e e-mail-eve për dërgimin e ofertave të kompanive të interesuara të përcaktuara nga Administratori, nuk kanë përfshirë të gjithë anëtarët e komisionit të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes;

- Ka pasur raste që paraqitja e ofertave ju është kërkuar kompanive shitëse të energjisë brenda një afati më të vogël se 24 orë, duke vepruar në kundërshtim me pikën 3 të nenit 13 të Rregullores.

- Ofertat nuk janë dërguar njëherazi dhe me e-mail, si dhe gjatë kërkesave për negocim, ka pasur raste që kompanive shitëse ju janë lënë në dispozicion më pak se 4 orë pune, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 13 të Rregullores.

- Megjithëse në ftesën për ofertë është përcaktuar kusht skualifikues paraqitja së bashku me ofertën dhe e deklaratës së pranimit të dispozitave të kontratës, asnjëra nga kompanitë dhe në asnjërin prej ofertave në të gjitha raundet e negocimit nuk e kanë sjellë një dokument të tillë dhe nga ana e tjetër janë pranuar në negocim dhe nënshkrim kontrate.

- Ka pasur raste të moszbatimit të pikës 3 të nenit 13 për hapjen e leximit të ofertave në prani të palëve në orën dhe datën e përcaktuar në ofertë, sipas ankimimit të një kompanie, duke shfaqur mungesë transparence të procedurave.

- Megjithëse kompanive, gjatë negocimit ju është kërkuar vetëm ulja e çmimit, ka raste që kompanitë kanë modifikuar dhe sasinë, si dhe uljet e ndjeshme të çmimit janë përgjithësisht në raundet e fundit (të tretë dhe të katërt).

- Ndryshimi i çmimit në ofertat përfundimtare, kryesisht midis dy operatorëve, dhe është shumë i vogël: 0.04, 0.05, 0.10 deri në 0.50 euro/MWh, për të cilat lind dyshimi i arsyeshëm për ndikimin e OSHE në tregun e blerjes së energjisë elektrike prej saj.

Për të gjitha mangësitë e mësipërme gjatë zbatimit të procedurave të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, ngarkohet me përgjegjësi z. në cilësinë e Administratorit të CEZ Shpërndarje Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm.

3. Në procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes në periudhën janar-korrik 2014, CEZ Shpërndarje Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm i është shkaktuar një dëm ekonomik **në vlerën 9,727,223.4 euro**, si rezultat i blerjes së energjisë elektrike me çmime shumë më të larta se çmimet e tregut (përfshirë dhe kostot të transportit të energjisë), nga 7.94 euro deri në 13.12 euro për MWh. Në këtë mënyrë është rritur barrën e buxhetit të shtetit dhe shpenzimet e konsumatorëve, për të cilat ngarkohet me përgjegjësi z., në cilësinë e Administratorit të CEZ Shpërndarje Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm;

4. Në muajin janar 2014, janë nënshkruar dhe realizuar dy kontrata të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes prej 23,808 MWh me kompaninë me datë 30.12.2013 me vlerë 1,660,608 euro, si dhe prej 5 MWh me kompaninë me datë 17.01.2014 me vlerë 108,477.6 euro, **gjithsej 1,769,085.6 euro, sasi të cilat nuk kanë qenë pjesë të ofertave dhe nuk kanë kaluar në procedurë blerjeje, duke shkelur barazinë e pjesëmarrësve në procedura tenderimi, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi z., në cilësinë e Administratorit të CEZ Shpërndarje Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm.**

5. Nga auditimi i zbatimit të programit të furnizimit me energji elektrike për dy kontratat e muajit qershor 2014, konstatohet se subjektet dhe nuk janë ndëshkuar për mos furnizimin ditor sipas kushteve kontraktuale, duke cenuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe duke shmangur penalizmin e këtyre dy subjekteve, pra një trajtim i diferencuar i subjekteve, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi z., në cilësinë e administratorit të CEZ Shpërndarje Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm (*Trajtuar më hollësisht në faqet 137-191, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë

Administratori i Shoqërisë dhe Drejtoria e Tregtimit të Energjisë, të marrë masat e nevojshme për zbatimin me rigorozitet të kuadrit rregullator përkatës për të gjitha procedurat e blerjes së energjisë elektrike, përfshirë dhe ato për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Administratori i Shoqërisë dhe Drejtoria e Tregtimit të Energjisë, të marrë masat e nevojshme, që para kryerjes së procedurave të blerjes së energjisë të kryejë analiza dhe studime mbi variantin më efektiv të blerjes lidhur me sasinë e ndarjen në lote, bazën e furnizimit, kohën etj., me qëllim blerjen me çmime në nivel tregu, pa cenuar furnizimin e vazhdueshëm të popullatës me energji elektrike.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Administratori i Shoqërisë dhe Drejtoria e Tregtimit të Energjisë, të përcaktojë specialistë për monitorimin e zbatimit të kushteve kontraktuale, jo vetëm për sasinë mujore por edhe atë orare, duke zbatuar penalitetet përkatëse dhe trajtim të barabartë të operatorëve në treg, në funksion të garantimit të furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike të vendit.

Menjëherë dhe vazhdimisht.

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për orientimin e investimeve në drejtim të përmirësimit të rrjetit të shpërndarjes dhe nënstacioneve, për uljen e humbjeve teknike, si dhe identifikimin dhe eliminimin e të gjitha humbjeve ekonomike të cilat ndikojnë negativisht në bilancin energjetik.

Menjëherë dhe vazhdimisht

8/3. Nga auditimi i zbatimit të procedurave të shitblerjes së energjisë elektrike, u konstatua ulje artificiale e humbjeve teknike me pasojë dëmtimin e interesave të ligjshme të shoqërisë "KESH" sh.a dhe të buxhetit të shtetit, për vitin 2013 dhe 2014 në vlerën 1,547,032,313 lekë, ose 11,082,687 euro.

Konkretisht:

Për vitin 2014 u konstatua se në mënyrë artificiale janë ulur humbjet teknike, veprim i cili është kryer me fatura të dyshimta (mbi faturim, keq faturim, faturim të abonentëve pa adresë si dhe abonentë që nuk kanë arkëtuar asnjëherë etj), si pasojë e të cilës:

-I është krijuar një dëm ekonomik shoqërisë "KESH" sh.a dhe buxhetit të shtetit në vlerën 1,547,032,313 lekë, ose 11,082,687 euro.

Ky faturim është bërë në mënyrë abuzive dhe të pasaktë, pasi reflekton një sasi të pa konsumuar të energjisë elektrike, por edhe një faturim fiktiv me abonent që nuk kanë arkëtuar

asnjëherë (të cilët rezultojnë aktiv në sistemin e faturimit, ndoshta nuk ekzistojnë etj), në kundërshtim me:

A-Ligjin 9072 datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me ndryshime, neni 51 i cili citon:

1-Energjia elektrike, e përdorur nga klienti, lexohet dhe faturohet sipas regjistrimeve të aparateve matës.

2-Instalimi i aparateve matës të energjisë elektrike bëhet në përputhje me kodin e matjes të energjisë elektrike, të miratuar nga ERE.

14-Llogaritja e demit ekonomik, shkaktuar kompanisë nga çdo ndërhyrje e paligjshme, bëhet në përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE.

Neni 52. Klientët pa matës

1-Operatori i sistemit të shpërndarjes është i detyruar të pajisë me sistem matjeje çdo klient të lidhur me sistemin e shpërndarjes.

2-Për klientët, që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk janë të pajisur me aparat matës, për një periudhë transitore, furnizuesi i propozon për miratim ERE-se një përdorim të llogaritur afrofe për këtë kategori klientësh, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga ERE-ja. Klienti, që nuk ka aparat matës, paguan në përputhje me këtë përlllogaritje.

3- Ere-ja në licencën e shpërndarjes ose furnizimit me energji elektrike, që i jep operatoreve, përcakton afatin e kohëzgjatjes së periudhës transitore, sipas pikës 2 të këtij neni.

B-Kontratën e furnizimit me energji elektrike për abonentët familjarë dhe jo familjarë, Neni 7 "Leximi i matësit dhe Faturimi i energjisë elektrike"

7.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit për një periudhë kohore 30 ditësh kalendarike dhe do të dërgojë Klientit në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit.

Neni 8

Faturimi i energjisë elektrike gjatë mosfunksionimit të aparatit matës

8.1 Faturimi i energjisë elektrike për ditët që klientit i është hequr aparati matës për shkak të kontrollit periodik me kërkesë të klientit apo furnizuesit, ose në rast të mosfunksionimit të aparatit matës do të bëhet bazuar në konsumin mesatarë ditore të muajit paraardhës, por jo më shumë se 30 ditë.

8.2 Nëse furnizuesi nuk respekton afatin 30 ditore për vendosjen e matësit të rregullt, atëherë përgjegjësia është e furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje të këtij afati, **do të jenë zero.**

C-Ligjin 8662 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike" datë 18.09.2000 (Trajtuar më hollësisht në faqet 137-191, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për ngritjen e një grupi pune, për identifikimin e të gjitha faturave të dyshimta (mbi faturim, keq faturim, faturim të abonentëve pa adresë, si dhe atyre që nuk kanë arkëtuar asnjëherë etj). Kjo për të eliminuar faturimin në mënyrë abuzive dhe të pasaktë, si dhe abuzimet nëpërmjet këtyre veprimeve apo mos veprimeve, gjë e cila reflekton një sasi të pa konsumuar të energjisë elektrike, si dhe ndikon në bilancin energjetik duke ulur fiktivisht humbjet.

Brenda datës 30.11.2015

8/4 .Të ardhurat e munguara për shoqërinë OSHEE nga eksporti i energjisë nga KESH, në import të energjisë në OSHEE.

Nga auditimi i procedurave të blerjes së energjisë elektrike për periudhën dhjetor 2014-shkurt 2015, dhe krahasimi me shitjen e po të njëjtës sasi energjie në të njëjtën periudhë sipas muajve respektive nga shoqëria KESH sha tek operatorët privat të tregut të energjisë, u konstatua një diferencë në vlerën 22,32 Euro/Mwh midis çmimit të shitjes së energjisë nga

KESH sha (34.80 Euro/Mwh) dhe çmimit të blerjes së energjisë nga OSHEE sha (57.12 Euro/Mwh), **me vlerë totale 5,630,713 euro.**

Konstatohet se: ERE me veprimet apo mosveprimet e saj, ka krijuar një situatë konfuzë në sistemin energjetik, jo vetëm në aktet e nxjerra prej saj, por dhe në monitorimin e shoqërive që operojnë në sistemin energjetik, me pasoje financiare për buxhetin e shtetit, kështu nëse KESH sh.a do t'ja kishte shitur energjinë direkt OSHEE-së me çmimin e eksportit prej 34.80 euro, për sasinë 213,600 Mwh, OSHEE-ja do të kishte kursyer 5,630,713.88 euro, dhe kjo vlerë nuk do të kalonte për llogari të kompanive që operojnë në tregun e energjisë në Shqipëri si:,,,dheetj.

Fenomen që është rregulluar në bazë të vendimit të ERE nr. 12, datë 06.02.2015 “ Për miratimin e marrëveshjes për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sha dhe OSHEE sha për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015”. Në zbatim të këtij vendimi është lidhur dhe marrëveshja midis dy shoqërive KESH sha me nr. 1026 prot. datë 06.02.2015 dhe OSHEE sha nr. 2614 prot., datë 06.02.2015.

Vlera 5,630,713.88 euro përbën një të ardhur të munguar për shoqërinë “OSHEE” dhe për buxhetin e shtetit, konstatim i cili do të merren në konsideratë në auditimin e radhës që KLSH do të zhvillojë në ERE (*Trajtuar më hollësisht në faqet 137-191, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Administratori i Shoqërisë të prezantohet në organet drejtuese **vlera 5,630,713.88 euro**, që përfaqëson, një diferencën midis çmimit të shitjes së energjisë nga KESH sha dhe çmimit të blerjes së energjisë nga OSHEE sha, me një diferencë çmimi prej rreth -22,32 Euro/Mwh me vlerë totale diferencë 5,630,713 Euro, **vlerë e cila përbën një të ardhur të munguar** për shoqërinë “OSHEE” dhe për buxhetin e shtetit, si dhe të zbatohet me rigorozitet dhe përgjegjësi vendimi i ERE nr. 12 datë 06.02.2015 .

Brenda datës 30.10.2015

9. Nga auditimi në sistemin e faturimit “Billing”, u konstatua që:

Në sistemin e faturimit “Billing” të shoqërisë OSHEE me teknikat kompjuterike (CAAT), u konstatua se sistemi informatik paraqet dobësi në pasqyrimin e saktë të informacionit dhe konkretisht në fushën e bazës së të dhënave me emër “NR_SERIAL” (e cila pasqyron kodin fiskal të faturës) me progresion rritës 1 (një), rezulton se:

1. Në 13,633,248 fatura të vitit 2013
 - a. Në 9 raste kanë vlerën 0 (zero).
 - b. Në 10 000 raste ka kapërcime të numrit serial.
2. Në 14,119,060 fatura të vitit 2014
 - a. Në 65 raste kanë vlerën 0 (zero).
 - b. Në 3059 raste ka kapërcime të numrit serial.

Në 13,059 rastet e evidentuara me kapërcime të numrit serial, mund të krijojnë të ardhura të pa evidentuara dhe rrezikun e evazionit fiskal. Grupi i auditimit shprehet me rezervë për saktësinë dhe vërtetësinë e kësaj shifre, për arsye jo vetëm se nga drejtoria e shitjes nuk u vu në dispozicion i gjithë dokumentacionit justifikues, por edhe ai që u vu ishte me mangësi, dhe se ky dokumentacion nuk respekton kërkesën e materialitetit dhe të paraqitjes së sinqertë dhe të vërtetë të regjistrimit, duke respektuar plotësisht dispozitat ligjore, në funksion të aktivitetit të kësaj shoqërie (*Trajtuar më hollësisht në faqet 191-193, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

1. Për 13.059 rastet e konstatuara në sistemin Billing në problematikën e faturimit, nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të zbatohen procedurat audituese për problemin e

konstatuar, dhe për të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e tyre, të informojë Kontrollin e Lartë të Shtetit, Këshillin Mbikëqyrës dhe Administratorin e Shoqërisë

Brenda datës 30.11.2015

2. Drejtorja e Auditit të Brendshëm të kryejë kontrollin dhe monitorimin periodik të gjurmëve të sistemit të informacionit dhe analizimin e riskut operacional.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

3. Nga Këshilli mbikëqyrës dhe Administratorit të Shoqërisë të merren masa për rishikimin e rregullores së brendshme, përshkrimeve të punës dhe ndarjes së detyrave në përdoruesit e sistemeve të informacionit.

Menjëherë

10. Nga auditimi i procedurave të mbledhjes së borxhit të energjisë elektrike, u konstatua që:

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga OSHEE, u konstatua se kompanitë e kontraktuara për mbledhjen e borxhit të energjisë elektrike, kanë përfituar padrejtësisht nga ish “CEZ Shpërndarje” Sha **vlerën 847,936,386 lekë, ose 6,074,478 euro.**

Nga 9 kontrata të evidentuara gjatë auditimit, si kontrata të lidhura ndërmjet “CEZ Shpërndarje” Sha dhe kompanive për mbledhjen e borxheve të energjisë elektrike, nga grupi i auditimit u arrit të auditoheshin vetëm 4 prej tyre, si pasojë e vështirësive të mëposhtme:

- Mungesës së një inventari të plotë të llogarive (inventar fizik të aseteve dhe inventar kontabël) të Shoqërisë “CEZ Shpërndarje” Sha, si në momentin e kalimit të kësaj shoqërie nën administrimin e përkohshëm të shtetit më datë 21.01.2013, ashtu edhe pas kësaj date deri në periudhën e përfundimit të këtij auditimi.
- Mosdisponimit të programeve autentike të Shoqërisë “CEZ Shpërndarje” Sha (SAP - Programi i kontabilitetit, Billing – Programi i faturimit dhe Mobirid- Programi i leximit të matësve), mbi bazën e të cilave kjo kompani menaxhonte dhe administronte aktivitetin e saj, që nga momenti i kalimit të kësaj shoqërie nën administrimin e përkohshëm të shtetit dhe deri më periudhën e përfundimit të këtij auditimi.
- Ekzistencës së të dhënave kontradiktore në dokumentacionin e disponuar në OSHEE nga dega ekonomike, drejtorja ligjore dhe drejtorja e shitjes.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, evidentohet fakti që për kompanitë:,, dhe, nga ana e Shoqërisë “CEZ Shpërndarje” Sha nuk disponohet dokumentacioni i plotë për justifikimin e pagesave të dhëna kompanive të mbledhjes së borxheve, **çka ngre dyshime serioze për përfitim të padrejtë** të këtyre shoqërive nga Shoqëria “CEZ Shpërndarje” Sha.

Për rrjedhojë, për sa kohë nuk vërtetohet me dokumentacion të plotë justifikues zbatimi i detyrimeve kontraktore të kompanive të mbledhjes së borxheve, do të konsiderohet si **dëm ekonomik vlera prej 847,936,386 lekë** e përfituar në mënyrë të padrejtë nga kompanitë si më poshtë:

- Kompania në vlerën 35,258,785 lekë.
- Kompania në vlerën 649,803,420 lekë.
- Kompania në vlerën 10,300,312 lekë.
- Kompania në vlerën 152,573,869 lekë.

Për sa më sipër, në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e një opinioni të plotë dhe të saktë të grupit të auditimit, mbi zbatimin e kuadrit rregullator mbi të cilin kanë ushtruar aktivitetin e tyre si Shoqëria “CEZ Shpërndarje” Sha, ashtu edhe kompanitë e mbledhjes së borxhit, grupi i auditimit shprehet me rezervë për saktësinë dhe vërtetësinë e vlerës prej 847,936,386 lekë.

Në referencë të konstatimeve të auditimeve që Kontrolli i Lartë i Shtetit ka zhvilluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në bazë të programit të auditimit nr. 118/1, datë

12.03.2015, i ndryshuar dhe në Avokaturën e Shtetit në bazë të programit të auditimit nr. 264/1, datë 17.03.2015, i ndryshuar, kjo vlerë prej 847,936,386 lekë dhe çështja e kryerjes së këtyre pagesave të pajustificuara nga Shoqëria “CEZ Shpërndarje” Sha, duhet të ishte marrë në konsideratë gjatë procesit të negocimit të marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe Shoqëria “CEZ a.s”, për më tepër referuar kallëzimit penal të bërë nga Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 526/34, datë 24.07.2013, lidhja dhe më pas zgjidhja e dy prej kontratave të mësipërme me kompanitë dhe është cilësuar si shpërdorim i kompetencave nga ana e administratorëve të atëhershëm të “CEZ Shpërndarje” Sha.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 137-191, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Auditit të Brendshëm të marrë masa të menjëhershme për të përfshirë në veprimtarinë e saj audituese, aktivitetin e të gjitha kompanive të mbledhjes së borxhit të keq të energjisë elektrike, dhe për të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e tyre, të informohet Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë.

Gjithashtu, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të organizojë punën për auditimin e plotë të veprimtarisë administruese dhe menaxhuese, ekonomike dhe financiare të CEZ Shpërndarje Sha, në periudhën e administrimit të përkohshëm duke filluar nga data 21.01.2013. Gjithashtu, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të organizojë punën për auditimin e plotë të veprimtarisë administruese dhe menaxhuese, ekonomike dhe financiare të CEZ Shpërndarje Sha, për periudhën e administrimit të përkohshëm të kësaj kompanie, duke filluar nga data 21.01.2013, duke analizuar në veçanti kallëzimin penal të Avokaturës së Shtetit, përcjellë organit të Prokurorisë me shkresën nr. 526/34, datë 24.07.2013.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Nga auditimi u konstatua se për vitin 2013, shoqëria “Cez shpërndarje” në administrim të përkohshëm, ka dhënë shpërblime në fund të vitit për të gjithë punonjësit në masën e 10,000 lekë, ***në shumën 47,040,000.00 lekë, kjo shumë përbën dëm ekonomik për shoqërinë***, sepse është dhënë në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodin e Punës”, i ndryshuar, neni 114 “Shpërblimi”, pika 1, e cili përcakton se: “Nëse palët bien dakord, punëdhënësi i jep punëmarrësit një shpërblim të veçantë mbi pagë, në fund të vitit, duke marrë parasysh cilësinë e punës së tij ose mbarëvajtjen e ndërmarrjes, vendimin e ERE nr. 1, datë 10.01.2013 “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, neni 12, pika 3, përcakton kompetencat e Administratorit, dhe detyrimin për miratim në ERE të strukturës, pagave dhe shpërblimeve *(Trajtuar më hollësisht në faqet 38-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të rishqyrtojë shpërblimin e dhënë për punonjësit e Shoqërisë për vitin 2013 ***në vlerën 47,040,000 lekë***, për arsye se është dhënë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodin e Punës”, i ndryshuar, neni 114 “Shpërblimi”, pika 1, Vendimin e Entit Rregullator të Energjisë nr. 1, datë 10.01.2013, “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, ***vlerë e cila për Shoqërinë “CEZ Shpërndarje” Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm (aktualisht OSHEE) dhe buxhetin e shtetit, përbën dëm ekonomik.***

Brenda datës 30.10.2015

2. Nga auditimi u konstatua se me veprimin datë 27.02.2015 dhe datë 24.04.2015 (Raiffeisen Bank) i është likuiduar subjektit vlera 56,705,902 lekë, për blerje kancelari sipas kontratës së furnizimit të lidhur me nr. 7021/17, datë 21.07.2014, me objekt “Furnizimin në mënyrë të vazhdueshme të artikujve sipas aneksit nr. 1”, për një periudhë 1-vjeçare pa

ndryshuar çmimet e paraqitura të artikujve. Kontrata është firmosur nga z. në cilësinë e Administratorit të Përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” SHA.

Më datën 01.08.2014 nga Sektori i Shërbimeve të Brendshme, është hartuar kërkesë në formë procesverbali për blerjen e 24 artikujve, të cilët nuk ishin parashikuar në kontratën me nr. 7021/17, datë 21.07.2014.

Pas kësaj kërkesë është hartuar amendamenti (shtesë kontrate) i firmosur nga, në cilësinë e Administratorit të Përkohshëm. Në listën e artikujve që shoqëron shtesën e kontratës fillestare, janë shtuar jo vetëm artikujt e kërkuar, por janë shtuar artikuj të tjerë, nga të cilët 28 artikuj kancelarie dhe 40 lloje të tjera tonera, kjo në kundërshtim kontratën e sipërcituar, nenin 9.4, si dhe në kundërshtim dhe rregulloren e prokurimeve të miratuar me Vendimin nr. 145, datë 09.12.2013 të ERE-s, të pikës 3.3.3 “Përdorimit të kontratave aktuale me furnizuesit”.

Vlera 3,092,056 lekë, ose 22,086 euro për shoqërinë “CEZ Shpërndarje” Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm (aktualisht OSHEE) dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik** (Trajtuar më hollësisht në faqet 45-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **3,092,056 lekë nga** në cilësinë e ish-administratorit. Kjo vlerë ka të bëjë me shtesë të kontratës së furnizimit nr. 7021/17, datë 21.07.2014 me objekt “Blerje kancelari” me kontratën nr. 7021/22, datë 15.08.2014, duke shtuar, 28 artikuj kancelarie dhe 40 lloje tonerash në mënyrë të pa justifikuar. Dëmshpërblimi mbështetet në nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 163, pika 3.

Brenda datës 31.12.2015

3. Nga auditimi u konstatua se me veprimin datë 12.03.2015, i është likuiduar shoqërisë, (Intesa San Paolo) 30,000,000 lekë, për likuidim pjesor të faturës me nr. 1021, datë 12.11.2014, për blerje materiale elektrike. Kjo blerje është bërë në zbatim të kontratës shtesë me nr. 8577, datë 21.07.2014 me vlerë 112,863,032.9 pa TVSH dhe 135,435,639.4 me TVSH. Kjo shtesë kontrate është bërë në zbatim të kontratës së lidhur me nr. 25525/49, datë 06.01.2014 me të njëjtin subjekt, për blerje material elektrike me vlerë 187,028,388 lekë. Kontrata e parë si dhe shtesa e kontratës janë të shoqëruara me anekse ku janë paraqitur llojet e materiale. Në shtesën e kontratës materialet janë të njëjtat me ato të aneksit të kontratës bazë. Grupi i auditimit verifikoi gjendjen e disa materialeve në magazinë, të cilat janë dhe në aneksin e shtesës së kontratës, dhe rrezultoj se gjendja e tyre në magazine është në sasi të konsiderueshme, pra këto materiale të blera me shtesën e kontratës janë të panevojshme, duke rënduar në këtë mënyrë padrejtësisht shpenzimet e shoqërisë.

Veprimet janë në kundërshtim me rregulloren e prokurimeve të miratuar me Vendimin nr. 145, datë 09.12.2013 të ERE-s, pika 3.3.3. **Vlera 988,462 lekë** për shoqërinë “CEZ Shpërndarje” Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm (aktualisht OSHEE) dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik** (Trajtuar më hollësisht në faqet 45-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **988,462 lekë nga** në cilësinë e ish-administratorit. Kjo vlerë ka të bëjë me shtesë të kontratës së furnizimit me nr. 25525/49, datë 06.01.2014 me objekt “Blerje material elektrike” me kontratën nr. 8577, datë 21.07.2014, duke shtuar, në mënyrë të pa justifikuar materiale elektrike, të cilat janë të njëjtat me ato të kontratës bazë, dhe që gjendja e tyre në magazine është në sasi të konsiderueshme. Dëmshpërblimi mbështetet në nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit

juridik” të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 163, pika 3.

Brenda datës 31.12.2015

4. Nga auditimi i procedurave të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes në periudhën janar-korrik 2014, CEZ Shpërndarje Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm i është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 9,727,223.4 euro, si rezultat i blerjes së energjisë elektrike me çmime shumë më të larta se çmimet e tregut (përfshirë dhe kostot të transportit të energjisë), nga 7.94 euro deri në 13.12 euro për MWh. Në këtë mënyrë është rritur barra e buxhetit të shtetit dhe shpenzimet e konsumatorëve, për të cilat ngarkohet me përgjegjësi z., në cilësinë e Administratorit të CEZ Shpërndarje Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm (*Trajtuar më hollësisht në faqet 45-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të shqyrtojë **vlerën 9,727,223.4 euro**, për mos zbatimin e rregullave dhe procedurave të blerjes të energjisë elektrike për mbulimin e humbjes në sistemin e shpërndarjes në periudhën janar-korrik 2014, të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Shoqërinë “CEZ Shpërndarje” Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm (aktualisht OSHEE) dhe buxhetin e shtetit, përbën dëm ekonomik.

Brenda datës 31.12.2015

5. Nga auditimi i zbatimit të procedurave të shitblerjes së energjisë elektrike, u konstatua se është realizuar “Ulje artificiale e humbjeve teknike me pasojë dëmtimin e interesave të ligjshme të shoqërisë dhe të buxhetit të shtetit”, për vitin 2014 në vlerën **1,547,032,313 lekë, ose 11,082,687 euro**.

Konkretisht:

Për vitin 2014 u konstatua se në mënyrë artificiale janë ulur humbjet teknike, veprim i cili është kryer me fatura të dyshimta (mbi faturim, keq faturim, faturim të abonentëve pa adresë si dhe abonentë që nuk kanë arkëtuar asnjëherë etj), si pasojë e të cilës i është krijuar një dëm ekonomik shoqërisë “KESH” sh.a dhe buxhetit të shtetit në vlerën 1,565,510,504 lekë. Ky faturim është bërë në mënyrë abuzive dhe të pasaktë, pasi reflekton një sasi të pa konsumuar të energjisë elektrike, por edhe një faturim fiktiv me abonent që nuk kanë arkëtuar asnjëherë (rezultojnë aktiv në sistemin e faturimit, ndofta faktikisht nuk ekzistojnë etj), në kundërshtim me:

-Ligjin 9072 datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me ndryshime, neni 51 dhe 52.

-Kontratën e furnizimit me energji elektrike për abonentët familjarë dhe jo familjarë, nenet 5,7,8,9,10 dhe 11.

-Ligjin 8662 datë 18.09.2000 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike" (*Trajtuar më hollësisht në faqet 137-191, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të shqyrtojë **vlerën 1,547,032,313 lekë, ose 11,082,687 euro**.

Kjo vlerë ka të bëjë me uljen artificiale të humbjeve teknike për vitin 2014, veprim i cili është kryer me fatura të dyshimta (mbi faturim, keq faturim, faturim të abonentëve pa adresë, si dhe ata që nuk kanë arkëtuar asnjëherë etj). Ky faturim është bërë në mënyrë abuzive dhe të pasaktë, pasi reflekton një konsum të pakonsumuar të energjisë elektrike, por edhe një faturim fiktiv me abonent që nuk kanë arkëtuar asnjëherë (që ndofta janë mbyllur, nuk ekzistojnë etj). Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila

për shoqërinë “CEZ Shpërndarje” Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm (aktualisht OSHEE) dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Brenda datës 31.12.2015

6. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga OSHEE, u konstatua se kompanitë e kontraktuara për mbledhjen e borxhit të energjisë elektrike, kanë përfituar padrejtësisht nga ish “CEZ Shpërndarje” Sha **vlerën 847,936,386 lekë, ose 6,074,478 euro.**

Nga 9 kontrata të evidentuara gjatë auditimit, si kontrata të lidhura ndërmjet “CEZ Shpërndarje” Sha dhe kompanive për mbledhjen e borxheve të energjisë elektrike, nga grupi i auditimit u arrit të auditoheshin vetëm 4 prej tyre, si pasojë e vështirësive të mëposhtme:

- Mungesës së një inventari të plotë të llogarive (inventar fizik të aseteve dhe inventar kontabël) të Shoqërisë “CEZ Shpërndarje” Sha, si në momentin e kalimit të kësaj shoqërie nën administrimin e përkohshëm të shtetit më datë 21.01.2013, ashtu edhe pas kësaj date deri në periudhën e përfundimit të këtij auditimi.
- Mosdisponimit të programeve autentike të Shoqërisë “CEZ Shpërndarje” Sha (SAP - Programi i kontabilitetit, Billing – Programi i faturimit dhe Mobirid- Programi i leximit të matësve), mbi bazën e të cilave kjo kompani menaxhonte dhe administronte aktivitetin e saj, që nga momenti i kalimit të kësaj shoqërie nën administrimin e përkohshëm të shtetit dhe deri në periudhën e përfundimit të këtij auditimi.
- Ekzistencës së të dhënave kontradiktore në dokumentacionin e disponuar në OSHEE nga dega ekonomike, drejtoria ligjore dhe drejtoria e shitjes.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, evidentohet fakti që për kompanitë:,, dhe, nga ana e Shoqërisë “CEZ Shpërndarje” Sha nuk disponohet dokumentacioni i plotë për justifikimin e pagesave të dhëna kompanive të mbledhjes së borxheve, **çka ngre dyshime serioze për përfitim të padrejtë** të këtyre shoqërive nga Shoqëria “CEZ Shpërndarje” Sha.

Për rrjedhojë, për sa kohë nuk vërtetohet me dokumentacion të plotë justifikues zbatimi i detyrimeve kontraktore të kompanive të mbledhjes së borxheve, do të konsiderohet si **dëm ekonomik vlera prej 847,936,386 lekë** e përfituar në mënyrë të padrejtë nga kompanitë si më poshtë:

- Kompania në vlerën 35,258,785 lekë.
- Kompanianë vlerën 649,803,420 lekë.
- Kompania në vlerën 10,300,312 lekë.
- Kompania në vlerën 152,573,869 lekë.

Për sa më sipër, në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e një opinionit të plotë dhe të saktë të grupit të auditimit, mbi zbatimin e kuadrit rregullator mbi të cilin kanë ushtruar aktivitetin e tyre si Shoqëria “CEZ Shpërndarje” Sha, ashtu edhe kompanitë e mbledhjes së borxhit, grupi i auditimit shprehet me rezervë për saktësinë dhe vërtetësinë e vlerës prej 847,936,386 lekë.

Në referencë të konstatimeve të auditimeve që Kontrolli i Lartë i Shtetit ka zhvilluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në bazë të programit të auditimit nr. 118/1, datë 12.03.2015, i ndryshuar dhe në Avokaturën e Shtetit në bazë të programit të auditimit nr. 264/1, datë 17.03.2015, i ndryshuar, kjo vlerë prej 847,936,386 lekë dhe çështja e kryerjes së këtyre pagesave të pajustificuara nga Shoqëria “CEZ Shpërndarje” Sha, duhet të ishte marrë në konsideratë gjatë procesit të negocimit të marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe Shoqëria “CEZ a.s”, për më tepër referuar kallëzimit penal të bërë nga Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 526/34, datë 24.07.2013, lidhja dhe më pas zgjidhja e dy prej kontratave të mësipërme me kompanitë dhe është cilësuar si shpërdorim i kompetencave nga ana e administratorëve të atëhershëm të “CEZ Shpërndarje” Sha. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 137-191, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

OSHEE të ndërmarrë të gjitha procedurat e nevojshme për verifikimin dhe vërtetimin e saktësisë së vlerës totale prej 847,936,386 lekë, e cila rezulton si përfitim i padrejtë i kompanive të mbledhjes së borxhit, ndaj të cilave në rast të mos evidentimit të dokumentacionit të plotë justifikues për përfitimin e kësaj vlere, duhet të iniciojnë procedurat përkatëse administrative dhe gjyqësore të arkëtimit nga kompanitë si më poshtë:

- Kompania **në vlerën 35,258,785 lekë,**
- Kompania **në vlerën 649,803,420 lekë.**
- Kompania **në vlerën 10,300,312 lekë.**
- Kompania ".....**në vlerën 152,573,869 lekë.**

Brenda datës 31.12.2015

7. Nga auditimi i zbatimit të procedurave të blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve të energjisë në sistemin e shpërndarjes për vitin 2014 dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2015, u konstatua, se Kompanitë,,, kanë realizuar marrëveshje të ndaluara në procedurat e blerjes së energjisë elektrike, pasi kanë fshehur pozicionin e tyre të dyfishtë dhe kanë kryer tregti direkt të fshehtë, duke krijuar avantazh të paligjshme, duke mos respektuar rregullat e konkurrencës, me pasojë dëm ekonomik për llogari shoqërisë “OSHEE” sh.a të buxhetit të shtetit **në vlerën 428,950 euro, ose e konvertuar me kursin e bankës së Shqipërisë datës 31.07.2015 në vlerën 59,877,160 lekë** $428,950 \text{ euro} \times 139,59 = 59,877,160 \text{ lekë}$.

Veprime në kundërshtim me;

Ligjin nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës “ KREU I “ Marrëveshjet”, neni 4, i cili në mënyrë eksplicite citon “Marrëveshjet e ndaluara”.

1. Ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që:

a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;

b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;

c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;

ç) zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me palë të tjera tregtare, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;

d) kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.

2. Marrëveshjet që ndalohen, sipas pikës 1 të këtij neni dhe që nuk përjashtohen sipas nenëve 5, 6 dhe 7, janë të pavlefshme (Trajtuar më hollësisht në faqet 137-191, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të shqyrtohet nga Administratori i Shoqërisë dhe Departamenti Ekonomik **vlera 59,877,160 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me realizim të marrëveshjeve të ndaluara në procedurat e blerjes së energjisë për vitin 2014 dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2015, për mbulimin e humbjeve të energjisë në sistemin e shpërndarjes, nga Kompanitë,,, pasi kanë fshehur pozicionin e tyre të dyfishtë dhe kanë kryer tregti direkt të fshehtë, duke krijuar avantazh të paligjshme, duke mos respektuar rregullat e konkurrencës.

Vlera 59,877,160 lekë për shoqërinë “CEZ Shpërndarje” Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm (aktualisht OSHEE) dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik, dhe duhet të dëmshpërblehet nga**,,

Brenda datës 31.12.2015

8. Nga auditimi i procedurës “Blerje materiale elektrike emergjente për nevojat e shoqërisë”, viti 2014 (“CEZ Shpërndarje” Sha, me status të përkohshëm), u konstatua që:

-Procedura e prokurimit është trajtuar si procedurë emergjente e ndarë në katër lote, në kundërshtim me Rregulloren e Prokurimeve të “CEZ Shpërndarje” Sha miratuar me vendimin e ERE nr. 145 datë 09.12.2013, pika 3.4, e cila përcakton se: *“Blerje emergjente konsiderohen “Raste të tilla si tërmete, përmbajtje etj. Në raste emergjente procesi i blerjes mund të nis në bazë të një miratimi me e-mail të drejtorit të divizionit. Por pa asnjë vonesë për qëllim administrativ, kërkuesi duhet të vendos në PSA (SAP), një kërkesë të veçantë për miratimin standard të kërkesës”.*

Procedura e prokurimit është realizuar me një fazë negocimi, çka sjell akordimin e kontratave të operatoreve të kualifikuar që në fazën e parë, pa negociuar për një ofertë më të ulët. Kjo ka sjell shmangien e mundësisë që ka autoriteti konform rregullores, për të negociuar me firmat e kualifikuara në fazën e parë, për një ofertë të dytë financiare me vlerë me të ulët se oferta financiare e paraqitur në fazën e parë.

Veprim në kundërshtim me Rregulloren e Prokurimeve të “CEZ Shpërndarje” Sha, të miratuar me vendimin e ERE nr. 145 datë 09.12.2013, ku është përcaktuar procedurë me tre faza. Sipas Shtojcës nr. 4 (orari i tenderimit) të kësaj rregulloreje, pas vlerësimit të fazës së parë, autoriteti duhet t'i dërgojë furnizueseve të mundshëm kërkesë për oferta të reja financiare për fazën e dytë dhe të tretë.

Për të katër lotet, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprime në kundërshtim me Rregulloren e Prokurimeve të “CEZ Shpërndarje” Sha, të miratuar me vendimin e ERE nr. 145 datë 09.12.2013.

Për pos shkeljeve të trajtuar si më sipër, z. me detyrë ish-administrator i përkohshëm për periudhën 18.10.2013 deri më 03.11.2014 dhe me detyrë drejtor i shërbimeve mbështetëse të “CEZ Shpërndarje” Sha, në tejkallim të kompetencës, pa procedurë tenderimi, mbi nevojat urgjente kanë realizuar shtesa kontrate për të katër lotet me vlerë totale 528,915,975 lekë, në kundërshtim me Rregulloren e Prokurimeve të “CEZ Shpërndarje” Sha të miratuar nga ERE, me vendimin e ERE nr. 145 datë 09.12.2013.

Kjo vlerë ka të bëjë me shtesat e kontratave të furnizimit me nr. 25525/48 Prot., datë 06.01.2014 me vlerë 587,846,496 lekë, nr. 25525/49 prot., datë 06.01.2014 vlerë 187,028,388 lekë, nr. 25525/50 Prot., datë 06.01.2014 me vlerë 46,338,160 lekë, nr. 13,320 Prot., datë 06.01.2014 me vlerë 16,320,000 lekë me objekt “Blerje materiale elektrike emergjente për nevojat e shoqërisë”, viti 2014 të Shoqërisë “CEZ Shpërndarje” Sha, me status të përkohshëm” me kontratat respektive;

-nr. 8576 prot., datë 21.07.2014 lidhur ndërmjet “CEZ Shpërndarje” Sha përfaqësuar nga në cilësinë e ish-administratorit të shoqërisë dhe Bashkimi i Operatorëve **në vlerën 333,955,536 lekë.**

-nr. 8577 Prot., datë 21.07.2014 ndërmjet “CEZ Shpërndarje” Sha përfaqësuar nga dhe bashkimi i operatorëve **në vlerën 135,435,639 lekë.**

-nr. 8578 Prot., datë 21.07.2014, ndërmjet Cez Shpërndarje sh.a përfaqësuar nga dhe **në vlerën 18,724,800 lekë.**

-nr. 8579 prot., datë 21.07.2014, ndërmjet “CEZ Shpërndarje” Sha sh.a përfaqësuar nga dhe për kontratën bazë me nr. 13,320 Prot., datë 06.01.2014 **në vlerën 40,800,000 lekë .**

Vlera 528,915,975 lekë për shoqërinë “CEZ Shpërndarje” Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm (aktualisht OSHEE) dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik (Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të shqyrtojë **vlerën 528,915,975 lekë.** Kjo vlerë ka të bëjë me shtesat e kontratave të furnizimit me nr. 25525/48 Prot., datë 06.01.2014 me vlerë 587,846,496 lekë, nr. 25525/49 prot., datë 06.01.2014 vlerë 187,028,388

lekë, nr. 25525/50 Prot., datë 06.01.2014 me vlerë 46,338,160 lekë, nr. 13,320 Prot., datë 06.01.2014 me vlerë 16,320,000 lekë me objekt “Blerje materiale elektrike emergjente për nevojat e shoqërisë”, viti 2014 të Shoqërisë “CEZ Shpërndarje” Sha, me status të përkohshëm” me kontratat respektive;

-nr. 8576 prot., datë 21.07.2014 lidhur ndërmjet “CEZ Shpërndarje” Sha përfaqësuar nga

në vlerën 333,955,536 lekë.

-nr. 8577 Prot., datë 21.07.2014 ndërmjet Cez Shpërndarje përfaqësuar nga dhe bashkimi i operatorëve **në vlerën 135,435,639 lekë.**

-nr. 8578 Prot., datë 21.07.2014, ndërmjet Cez Shpërndarje sh.a përfaqësuar nga dhe **në vlerën 18,724,800 lekë.**

-nr. 8579 prot., datë 21.07.2014, ndërmjet Cez Shpërndarje sh.a përfaqësuar nga dhe për kontratën bazë me nr. 13,320 Prot., datë 06.01.2014 **në vlerën 40,800,000 lekë duke shtuar, në tejkallim të kompetencës, pa procedurë tenderimi dhe mbi nevojat urgjente, materiale elektrike, të cilat janë të njëjtat me ato të kontratave bazë, dhe që gjendja e tyre në magazinë në datën e nënshkrimit të kontratave, është në sasi të konsiderueshme. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për shoqërinë “CEZ Shpërndarje” Sha, Shoqëri në administrim të përkohshëm (aktualisht OSHEE) dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik .****

Brenda datës 31.12.2015

9. Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Blerje materiale elektrike”, viti 2014 të lidhur me Bashkimin e operatorëve për lotin e parë, u konstatua se dokumentacioni që shoqëron pajisjet dhe materialet elektrike me **vlerë 79,680,000 lekë**, nuk është i plotë dhe i saktë.

Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jepte opinion e Tij, për saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit që shoqëron pajisjet dhe materialet elektrike si: Autorizim prodhuesi, test raporti i fabrikës, çertifikatën e origjinës, faturat e furnitorit, çertifikatën e siguracionit, çertifikata e garancisë, dokumentin e transportit (CMR) etj, dhe të konfirmonte që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar, për të cilat Bashkimi i operatorëve ka fituar tenderin dhe është likuiduar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës (përjashtuar ata që kanë marrë pjesë në kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të pajisjeve materialeve), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve dhe materialeve elektrike, të konfirmojë që këto pajisje dhe materiale elektrike, janë ose jo të njëjta me ato të prokuruar, si dhe të verifikojë gjendjen e tyre teknike pas vendosjes në punë, nëse kanë qenë ose jo problematike.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet dhe materialet elektrike të furnizuara nga Bashkimi i operatorëve, nuk janë autentike, nuk janë konform specifikimeve teknike të përcaktuar në procedurën e tenderimit, dhe gjendja e tyre teknike pas vendosjes në punë ka qenë problematike (defekte etj), **konsiderohet dëm ekonomik** dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **arkëtimi i vlerës 79,680,000 lekë** nga Bashkimi i operatorëve Kjo çështje do të verifikohet nga KLSH, në vijimësi.

Brenda datës 31.12.2015

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës neni 61, kontratave individuale të punës,

pika 6, i kërkojmë Administratorit të Shoqërisë, që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

C/a. “Zgjidhje të kontratës së punësimit”

ose

“Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate” për:

1., me detyrë specialist / departamenti i burimeve njerëzore/drejtoria e menaxhimit të karrierës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit teknik.
2., me detyrë specialist/drejtoria e ofrimit të rrjetit në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit teknik.
3., me detyrë specialist (I Komanduar)/drejtoria e qeverisjes së korporatës/sektori i dokumentimit të proceseve dhe përputhshmërisë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit teknik.
4., me detyrë drejtor drejtorie /drejtoria e financës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit financiar.
5., me detyrë specialist /drejtoria e shërbimeve mbështetëse/sektori i prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit financiar.

Për arsye se në procedurën e prokurimit objekt “Blerje materiale elektrike emergjente për nevojat e shoqërisë”, viti 2014”, për të katër lotet, me vlerë **837,583,044**, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprime në kundërshtim me Rregulloren e Prokurimeve të Cez Shpërndarje sh.a, të miratuar me vendimin e ERE nr. 145 datë 09.12.2013.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për personat e përmendur më sipër, Administratori i Shoqërisë, sipas shkeljeve ligjore dhe përgjegjësiive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të performancës së punës së tyre, si dhe të masave disiplinore të dhëna më parë, mund të aplikoj një nga dy masat e rekomanduara.

“Vërejte” për:

1., me detyrë auditor/drejtoria e auditit të brendshëm/sektori juridik-inxhinjrik, në cilësinë e anëtarit të grupit të kolaudimit.
2., me detyrë shef dege /dega teknike/drejtoria rajonale Fier, në cilësinë e anëtarit të grupit të kolaudimit .

Për arsye se nga auditimi i zbatimit të kontratave me objekt “Blerje materiale elektrike viti 2014” të lidhur me Bashkimin e operatorëve për lotin e parë, u konstatua se dokumentacioni që shoqëron pajisjet dhe materialet elektrike me vlerë **79,680,000 lekë**, nuk është i plotë dhe i saktë.

Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jepte opinion e tij, për saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit që shoqëron pajisjet dhe materialet elektrike si: Autorizim prodhuesi, test raporti i fabrikës, çertifikatën e origjinës, faturat e furnitorit, çertifikatën e siguracionit, çertifikata e garancisë, dokumentin e transportit (CMR) etj, dhe të konfirmonte që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar, për të cilat Bashkimi i operatorëve ka fituar tenderin dhe është likuiduar *(Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3., me detyrë drejtor departamenti/departamenti i teknologjisë dhe informacionit, në cilësinë e anëtarit komisionit të vlerësimit të ofertave.
4., me detyrë specialist/drejtoria e planifikimit, zhvillim, projektim dhe standartizim/sektori i projektimit, në cilësinë e anëtarit komisionit të vlerësimit të ofertave.

5., me detyrë drejtor drejtorie/drejtorja e asistencës teknike, në cilësinë e anëtarit komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për arsye se në procedurën e prokurimit “Sistemi i G.I.S Asete”, viti 2015, “Sistemi i kamerave te survejimit”, viti 2015 , kualifikimi, shpallja fitues dhe lidhja e kontratës është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, 46, VKM nr. 914 date 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Kreu III, V, të ndryshuar, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6., me detyrë shef sektori/sektori i prokurimeve/drejtorja e shërbimeve mbështetëse, në cilësinë e anëtarit komisionit të vlerësimit të ofertave.

7., me detyrë drejtor drejtorie/drejtorja e planifikimit, zhvillim, projektim dhe standartizim, në cilësinë e anëtarit komisionit të vlerësimit të ofertave.

8., me detyrë shef sektori/drejtorja e asistencës teknike, matja, verifikim/sektori i asistencës teknike/njësia e menaxhimit të lidhjeve të reja TM,TU, në cilësinë e anëtarit komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për arsye se në procedurën e prokurimit “Blerje pajisje testuese për nevoja të OSHEE sh.a”, viti 2015, kualifikimi, shpallja fitues dhe lidhja e kontratës është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, 46, VKM nr. 914 date 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Kreu III, V, të ndryshuar, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9., me detyrë drejtor drejtorie/drejtorja e marrëdhënieve me klientin, në cilësinë e antarit komisionit të vlerësimit të ofertave.

10., me detyrë specialiste/njësia e çështjeve ligjore/drejtorja ligjore, në cilësinë e antarit komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për arsye se në procedurën e prokurimit “Katër kabinat Sallmone”, viti 2015, kualifikimi, shpallja fitues dhe lidhja e kontratës është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, 46, VKM nr. 914 date 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Kreu III, V, të ndryshuar, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11., me detyrë specialiste/drejtorja e planifikimit, kontrollit financiar dhe raportimit/departamenti ekonomik, në cilësinë e antares së blerjes së energjisë.

Menjëherë

Shënim

Për:,,,, dhe të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar, rezultojnë se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Për këta punonjës nuk është propozuar masë disiplinore, pasi masa ndaj tyre konsiderohet e ezauruar. Masa e propozuar do të ishte:

“Zgjidhje të kontratës së punësimit” për:, dhe

“Vërejte për zgjidhje kontrate” për:,dhe

Shënim:

1. *Theksojmë që ky auditim i KLSH-së do të ishte zhvilluar që në muajt e parë të vitit 2014, ku KLSH me shkresën nr. 263, datë 05.03.2014 kërkoi auditimin e CEZ Shpërndarje sha, i cili në atë periudhë kishte kaluar nën administrim të përkohshëm të Shtetit Shqiptar. Auditimi*

u pengua me të padrejtë nga administratori i CEZ Shpërndarje Sh.a., duke sjellë pengesa artificiale dhe të qëllimshme për ta refuzuar atë, si dhe për shkak të bllokimit që iu bë ligjit të ri organik të KLSH-së përgjatë gjithë vitit 2014.

2. Gjatë periudhës 2008-2012, CEZ Shpërndarje Sh.a. nuk ka qenë subjekt i auditimit nga KLSH si pasojë e faktit që Shteti zotëronte në atë kohë vetëm 24 përqind të aksioneve të kompanisë dhe KLSH me Kushtetutë nuk mund të auditojë kompani private ku Shteti ka më pak se 51 përqind të aksioneve.

3. Një pjesë e problematikës së administrimit publik të CEZ Shpërndarje Sh.a. është trajtuar edhe në dy auditimet që KLSH ka zhvilluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë përgjatë muajve mars-shtator 2015 dhe në Avokaturën e Shtetit, auditime të cilat janë drejt përfundimit.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatmir Iliazi, Gjovalin Preçi, Lavdie Fshazi, Kozma Kondakçiu, Skënder Hajdari, Migena Nushi dhe Mariglen Sinani, më tej u shqyrtua nga k/audituese Yllka Pulashi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.